



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të nenit 29 dhe 40, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datën, -----, miratoi këtë:

Projekt-V E N D I M

Për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-12153, të datës 28.02.2022 i ndryshuar dhe i plotësuar me vendimin 01-Nr-016-25493 i datës 28.04.2022

Neni 1.

Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimit, 01-Nr-016-12153 i datës 28.02.2022, i ndryshuar dhe i plotësuar me vendimin 01-Nr-016-25493 i datës 28.04.2022 i komisioni për ndarjen dhe definimin e banesave dhe lokaleve afariste në objektin afarist-banesor që do të ndërtohet në pronësi të Komunës nga **Bashkim Sali HOXHAI** dhe **z. Sami Dervish ELSHANI**, me qellim të dhënies së detyrave dhe përgjegjësi shtesë të anëtarëve të komisionit të cekur në vendimet e lartcekura.

Neni 2.

Pas nenit 2, të Vendimit bazik 01-Nr-016-12153 i datës 28.02.2022, i ndryshuar dhe i plotësuar me vendimin 01-Nr-016-25493 i datës 28.04.2022, shtohet një nen i ri, me tekstin si në vijim;

Neni 2 A

Komisionit të cekur në vendimet e lartcekura i shtohet edhe kjo detyrë dhe përgjegjësi që të bëjë kompensimin dhe barazimin e banesës Nr. 1 me sipërfaqe prej 48.74m² dhe banesës Nr. 2 me sipërfaqe prej 36.56m² me pronar Bashkim Sali Hoxha nga Suhareka, të cilat janë të ndërtuara në parcelën kadastrale P-72116046-01165-6 sipas certifikatës së pronës **nr. 37358-2023** datës 20.01.2023, zona kadastrale Suharekë, vendi i quajtura “Pojata/Sllloxha”, e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Kuvendit Komunal-Suharekë, e në cilën parcelë ka mu ndërtuar objekti afarist banesore nga investitorët e lartcekur. Kompensimi të bëhet në të njëjtin objekt ku kanë me ndërtuar investitorët në pronë të Komunës së lartcekur.

Neni 3

Ndërsa pjesët tjera kompletë të vendimit bazë me numër 01-Nr-016-12153 i datës 28.02.2022, i ndryshuar dhe i plotësuar me vendimin 01-Nr-016-25493 i datës 28.04.2022, mbesin të pa ndryshuara.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

K U V E N D I I K O M U N S Ë N Ë S U H A R E K Ë

01-Nr-_____
Me datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI